



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Maj 2023

Nr: 421

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 222 ID, TË ORGANIZATËS “KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT” DHE DENONCIMIT NR. 228 TË DEPUTETIT ZJ. ALBANA VOKSHI NDAJ DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, SI DHE MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 3 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Organizata “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”
Deputeti zj. Albana Vokshi

SUBJEKT: Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 2 (dy) denoncime, nga subjekte të ndryshme, për të njëjtin objekt. Organizata “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” dhe deputeti zj. Albana Vokshi, pretendojnë se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë ka adresuar

Data: 1 Maj 2023

Nr: 421
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 222 ID dhe nr. 228 ID”

kërkesa të përsëritura drejt stafeve pedagogjike për realizimin e një tabele Exel/ ku përfshihen të dhëna mbi mediat sociale të përdorura nga institucionet në varësi të kësaj zyre, duke shfrytëzuar burimet publike në kundërshtim më nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

- Organizata “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” nëpërmjet shkresës nr. 209 prot., datë 20.03.2023, administruar nga ana jonë me nr. 1780 prot., datë 21.03.2023 **regjistruar me nr. 222 ID**, pretendohet si më poshtë vijon:

“Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë, ka adresuar kërkesa të përsëritura drejt stafeve pedagogjike, për realizimin e një tabele Exel, ku përfshihen të dhëna mbi mediat sociale të përdorura nga këto Institucione. Përpos kësaj, në vijim të secilit link (ndërfaqe) të këtyre llogarive elektronike, është bërë e ditur se kërkohet informacion mbi numrin e ndjekësve të faqes, numrin e postimeve për veprimtaritë shkollore dhe numrin e ri-postimeve të kryera në llogaritë e rrjeteve sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Sipas nenit 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor, burime publike quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të prarashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Këto burime, si rregull nuk mund të përdoren apo të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose koalicioneve. Për të përforcuar më tej paligjshmërinë e këtij veprimi të ndërmarë, sipas nenit 3, pika 1.1.3.ç, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe /ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjete të komunikimit elektronik, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre, konsiderohet veprimtari e ndaluar”.

- Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë zj. Albana Vokshi, nëpërmjet denoncimit me numër unik 202 i gjeneruar nga sistemi, administruar nga ndërfaqja e denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe **i regjistruar me nr. 228 ID** ku pretendohet si më poshtë vijon:

“Legjislacioni aktual përcakton që arsimi duhet të jetë i depolitizuar, shkolla dhe drejtuesit e saj duhet të përmbushin sipas ligjit misionin e tyre. Asnjëherë më parë shkolla nuk ka qenë më e politizuar dhe e presionuar se sot. Drejtorive Arsimore dhe Rajonale, shkollave dhe kopshteve iu është kërkuar me tabelë e link për “like”, “share” në fb e shkollës. Akoma më keq në kopshte ku i’u kërkohet t’ju bëjnë “share” edhe aktiviteteve ndërkombëtare të Ramës. Vënia e shkollës në shërbim të fushatës apo presioni politik mbi mësuesit e nxënësit është shpërdorim detyre dhe ndëshkohet ligjërisht”.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoj

Data: 1 Maj 2023

Nr: 421
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 222 ID dhe nr. 228 ID”

se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 2 (dy) denoncime për të njëjtin subjekt dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Më datë 28.3.2023, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Zyrës Arsimore Parauniversitare Korçë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 29.3.2023, ZVAP KORÇË-PUSTEC bën me dije se: *“Në vijim të e-mailit tuaj ju informojmë se faqet zyrtare janë patjetër në kujdesin tonë të veçantë për të evituar çdo parregullsi në informimin e nxënësve, prindërve apo komunitetit, por në asnjë moment nuk është kërkuar informacion apo postime nga mësuesit apo drejtorët e shkollave për llogaritë e tyre personale. Monitorimi i faqeve zyrtare të shkollave është shumë i rëndësishëm për ne pasi këto faqe, ashtu si të çdo institucioni tjetër shërbejnë:*

- *Kryesisht për të promovuar aktivitetet e shkollave, talentet në këto shkolla dhe vlerat më të larta që mësohen dhe promovohen. Tashmë edhe prindërit në komunikimet e vazhdueshme me ta shprehin se hapësira digjitale nëpërmjet rrjeteve sociale, është mënyra më e mirë për promovimin e aktiviteteve nga të gjitha institucionet arsimore, qofshin në qytet apo në fshat. Në këtë mënyrë arrihet një publik më i gjerë se aktorët lokalë, shkollat mes tyre shpërndajnë ide edhe me shkollat e tjera, dhe rritet pjesëmarrja në aktivitete kombëtare e nxënësve pavarësisht mundësive të tyre ekonomike, sociale, vendbanimit, etj. Së fundi mund të përmendim konkursin digjital “Dhurata Për Mësuesin Tim”, një konkurs i organizuar dhe shpërndarë në rrjete sociale nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të cilin ne e kemi nxitur vazhdimisht edhe në shkolla që të shpërndahet sa më tepër në mënyrë që të gjithë nxënësit të informohen dhe të mund të marrin pjesë. Sigurisht në këtë proces, monitorimi i postimeve është një domosdoshmëri pasi administratorët e këtyre faqeve bëjnë një punë vullnetare dhe nuk janë gjithmonë ekspertë në komunikim, shpesh herë duhet verifikuar nëse këto postime janë të përshtatshme ose jo, psh të mos bëhet i ditur identiteti i të miturve pa pasur leje nga prindërit, ose që të mos jenë postime të kryera nga një orë mësimore, pasi është kategorikisht e ndaluar.*
- *Shpërndarja në kohë reale e postimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sic janë Urdhëra, Udhëzime, Rregullore si për shembull Rregullorja e Maturës Shtetërore. Kjo bëhet për arsye*

Data: 1 Maj 2023

Nr: 421
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 222 ID dhe nr. 228 ID”

të shpërndarjes së një informacioni publik tek të gjithë palët e interesuara siç janë nxënësit dhe prindërit. Duke qënë faqe zyrtare në rrjete sociale, shkolla ndërmerr dhe një hap më shumë për shpërndarjen e informacionit që i përket politikave arsimore, në mënyrë që palët e interesuara të vihen në dijeni për çdo risi.

- Monitorimi në situatë zgjedhore. Ky monitorim lind si nevojë e verifikimit që postimet të jenë vetëm brenda kornizave të aktiviteteve të institucioneve arsimore, ose ripostime të Urdhërave, Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Nëpërmjet raportimit të drejtorive të institucioneve arsimore, monitorohet që të mos ketë postime me karakter politik, partiak ose promovim kandidatësh. Institucionet arsimore e kanë detyrim ligjor të jenë të depolitizuara dhe monitorimi kryhet që ky detyrim ligjor të respektohet prej tyre. Për ne është shumë i rëndësishëm që në asnjë moment faqet zyrtare mos të përdoren për arsye partiake.
- Është kërkuar nga shkollat link-u zyrtar sepse ekzistojnë disa faqe rrjetesh sociale për të njëjtin institucion arsimor. Zyra Arsimore monitoron vetëm faqet aktive zyrtare të drejtorive të shkollave.

Theksojmë se në asnjë moment ky monitorim nuk është kërkuar nga punonjësit mësimore, por kryhet vetëm për faqet zyrtare të shkollave në rrjetet sociale, të menaxhuara nga drejtoritë në mënyrë që postimet të jenë konform ligjit dhe normave të etikës.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit z. Nebi Ganellari dhe zj. Migena Ramçi, të cilët mbajtën qëndrimet e tyre dhe dhanë sqarime lidhur me këtë proces hetimor.

Gjatë seancës publike përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit shprehet se: “*Theksojmë se e-mail me përmbajtjen excel, i janë dërguar institucioneve dhe jo adresave personale të stafit pedagogjik, me synimin që të verifikohet nëse këto faqe po përdoren për qëllime informim mbi veprimtaritë e institucioneve publike parauniversitare. Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka kryer një sërë veprimtarish konform ligjit, në repektim të ligjit dhe Kodit Zgjedhor. Pas përfundimit të fjalës, të njëjtën gjë konfirmoi dhe përfaqësuesja e Ministrisë.*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i Komitetit Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuesi i ZVAP KORÇË-PUSTEC, zj. Anila Bitraku dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit zj. Migena Ramçi, të cilët mbajtën qëndrimet e tyre dhe dhanë sqarime lidhur me këtë proces hetimor.

Në seancën publike, përfaqësuesi i Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtrori dy pyetje për përfaqësuesin ZVAP KORÇË-PUSTEC si më posht vijon:

1-“Cila është baza ligjore që ministria apo drejtoria i kërkon të bëni një raportim të tillë pra, plotësimin e një tabele exel?”

2-“A i keni monitoruar ju faqet e shkollave dhe a kanë ato postime të natyrës elektorale?”

Në vijim të seancës publike, përfaqësuesi i ZVA Korçë, Pustec, deklaroi për pytjet e bëra si më poshtë vijon: 1-“Në bazë të rregullores për funksionimin e zyrave vendore të arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë, neni 31 pika b.” Për sa i përket pyetjes së dytë: 2-“Është bërë monitorimi i faqeve dhe rezulton që nuk kanë postime të natyrës elektorale.”

Në vijim të seancës publike përfaqësuesi i Komiteti Shqiptar i Helsinkit u shpreh si më poshtë vijon: “Rezultoni se kërkohen të dhëna të cilat lidhen me numrin e ndjekësve në faqe, numrin e postimeve në veprimtarinë shkollore, numrin e ripostimeve të kryera në rrjete sociale dhe i gjithë ky informacion kërkohet për shpërndarjen e publikimeve të ministres. Ju kujtojmë se faqja e ministres përdoret edhe për publikimin e aktiviteteve politike”. Në mbyllje të fjalës së tij shprehet se: “Ne konstatojmë se ngritja e administrimit dhe përditësimi i të dhënave në ‘bazën e të dhënave exel’, ka si qëllim promovimin e veprimtarive të aktiviteteve të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv qëndror dhe subjekteve të përfshira në zgjedhje. Kërkojmë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, të merni masa për ndërprerjen e kësaj veprimtarie.”

Gjatë seancës publike përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit shprehet se: “Provat të cilat paraqiten nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janë marë nga faqe të ndryshme në FB, të cilat mund të mos jenë faqe zyrtare, të përdorura nga institucione.”

Në përfundim të pretendimeve dhe diskutimit të palëve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1 parashikon se “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qëndror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia**”. Po ky nen parashikon se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe **çdo burim njerëzor i institucionit**.

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3 pika 1.3, shkronja “ç”, parashikon se “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore

qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete **për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik**, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Referuar materialeve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe atyre të depozituara nëpërmjet denoncimeve, rezultoi se në faqet zyrtare “facebook” të disa institucioneve në varësi të ZVA Korçë-Pustec si dhe institucioneve të tjera arsimore, vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023. Megjithëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dhënë shpjegime të qarta në lidhje me dallimin midis faqeve zyrtare dhe atyre personale të drejtuesit të institucionit dhe vetë institucionit, vazhdohet të ketë paqartësi në lidhje me publikimet dhe ripostimet e tyre.

Për shkak të kufizimit që neni 3 pika 1.3, shkronja “ç”, parashikon “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore” dhe paqartësive në lidhje me postimet, urdhërohet ndalimi i ripostimit në faqet zyrtare të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilet personale të drejtuesit të një institucioni publik, për sa kohë këto profile i konsiderojnë profile të tyre personale.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 dhe 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Ndalimin e postimeve apo ripostimeve në rrjetet sociale të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik.
2. Fshirjen e menjëhershme të çdo postimi me karakter elektoral, nga rrjeti social i institucionit publik.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

Data: 1 Maj 2023

Nr: 421
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 222 ID dhe nr. 228 ID”

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 1 Maj 2023

Nr: 421
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 222 ID dhe nr. 228 ID”